



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

261/20
12.06.20

PSH.nr.261/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ALFA I” SH.P.K - Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë: OE “Rahovica Commerce” SH.P.K. – Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”, më datën: 11.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ALFA I” SH.P.K - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: “ALFA I” SH.P.K - Lipjan, aprovet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “ALFA I” SH.P.K - Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 21.04.2020 me nr. 261/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Implementimi i planit të mobilitetit - rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 61, 64, 69 si dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.04.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 08.05.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi Nr.1

Lidhur me pretendimin e OE “ALFA I” SH.P.K. – Lipjan– ankues - Sa i përket arsyes tonë për eliminim nga ana e AK-së ju sqarojmë se ne kemi bërë marrëveshje për huazim të pajisjeve nga “Eskavatori SHPK”, Kompani, kjo që ka dhe seli në Maqedoni (Bashkangjitur e keni marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve)

DUD-in doganor që e kemi prezantuar ne, është në pronësi e Eskavatorit MKD. Për ky mjet është dërguar në Maqedoni vetëm për realizimin e një projekti dhe është kthyer në Kosovë në të njëjtën gjendje (si dëshmi e kemi DUD-in që pajisja ka hyrë prapë në Kosovë por kjo dëshmi nuk ka qenë në dosjen e tenderit).

Ju sqarojmë se pronar i Eskavatorit MKD është Eskavatori SHPK (me atë që ne kemi marrëveshje për qiramarrje të makinerisë . (si dëshmi shtesë keni të bashkangjitur dokumentacionin e biznesit të ESKAVATORI MKD ku shihet qartë që pronar është Eskavatori SHPK), e ku kuptohet qartë se kjo pajisje e kontestuar nga Ak-ja është në pronësi të kompanisë me të cilën ne kemi bërë marrëveshje

paraprake, prandaj me këto dëshmi kuptohet dhe sqarohet se ne e kemi përmbushur kërkesën e FTD-së, e të cilën AK-ja e ka kontestuar.

Përgjigje Në Pretendimin Nr.1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, kërkesën të datës 11.03.2020 për plotësim të dokumentacionit shtesë të kërkuar nga AK-ja për pajisjen, dokumentacionin e dorëzuar nga OE "Alfa I" shpk në bazë të kësaj kërkesë dhe i cili dokumentacion nuk ka ndryshuar gjendjen nga ajo e me parme, sqaron se ky pretendim i OE bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Pretendimi Nr.2

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA. I" . – ankues se AK Komuna e Prishtinës ka bërë shkeljen e LPP-se duke e shpërblyer për kontratë një OE "Rahovica Commerce" sh.p.k për kontratë se është i pa përgjegjshëm për arsye se: Sa i përket udhëheqësit të punishtes të prezantuar nga OE të rekomanduar për kontratë, z. Shaban Krasniqi i cili edhe pse ka dy referenca të lëshuara nga Mirusha Company, më të cilën e plotëson kërkesën së ka kryer punë të ndërtimit të ultë dhe kërkesën për një projekt në vlerë prej 1.2 milion, në CV e z. Krasniqi nuk figuron askund se ka punuar në kompaninë Mirusha, por vetëm në kompanitë NNP "Liridoni" dhe NNSH "Top Projekt" gjithë ashtu nuk ka të përmendur asnjë projekt të ndërtimit të ultë, por tek përshkrimi thuhet se ka bërë menaxhimin e punimeve ndërtimore në këto kompani, por nuk dihet nëse punët e ndërtimit i përfshijnë edhe ato të ndërtimit të ulët apo vetëm të lartë. Këto dëshmi janë të dyshimta sepse po të kishte punuar inxhinieri në fjalë tek "Mirusha Company" atëherë do ta kishte shënuar edhe në CV-in e tij një gjë të tillë, prandaj është dashur të verifikohen këto dëshmi nga ana e AK-së.

Përgjigje Në Pretendimin Nr.2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE "Rahovica Commerce" sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë për Udhëheqësin e projektit z. Shaban Krasniqi inxh. dipl. i

ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv ka dorëzuar kontratën, referencat për punët e kryera si dhe CV-në siç janë kërkuar me FTD të dosjes së tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, mirëpo OE ankues "ALFA. I" pretendon se udhëheqësi i projektit i caktuar në bazë të vendimit të OE "Rahovica Commerce" sh.p.k në CV-in e tij nuk i ka të përshkruar eksperiencën profesionale në OE "Mirusha Company" e cila i ka lëshuar referencat për menaxhimin e projekteve në ndërtimin e ulëte për vitin 2016, 2017 dhe 2018.

Eksperti shqyrtues sqaron se CV-ja -dokumenti i ofruar nga OE "Rahovica Commerce" sh.p.k për Udhëheqësin e projektit z. Shaban Krasniqi inxh. dipl. i ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv paraqet devijim të vogël dhe në përgjithësi përmbushë kërkesën e kërkuar me FTD të dosjes së tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, kurse sa i përket kriterit që Udhëheqësi i punishtes duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë në vlerën e parashikuar të kontratës, në referencat e dorëzuar për Udhëheqësin e projektit ka dorëzuar dëshmi të kënaqshme.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar.

Pretendimi Nr.3

Lidhur me pretendimin e OE "ALFA. I" se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE "Rahovica Commerce" sh.p.k i rekomanduar me kontratë ka paraqitur dy inxhinier të ndërtimtarisë (z. Basret Selimi & z. Kadri Berisha), mirëpo nuk është përmbushur kërkesa e AK-së në këtë rast sepse punët e teknikeve të ndërtimtarisë duhet ti kryej tekniku e jo Inxhinieri, sepse kërkesë tjetër ka qen për inxhinier, pra janë kërkuar veçantë inxhinier e veçantë teknik të ndërtimtarisë.

Përgjigje Në Pretendimin Nr.3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE "Rahovica Commerce" sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit te kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme: - 2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo pike e ankese është e qëndrueshme sepse OE "Rahovica Commerce" sh.p.k ne dokumentacioni e ofruar me ofertë për 2 teknik te ndërtimtaria ka ofruar dokumentacionin për -2 inxhinier te diplomuar te ndërtimtarisë, andaj OE "Rahovica Commerce" sh.p.k me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë siç është kërkuar pasi qe ky kriter ka mundur qe te ndikoj

që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur teknik të ndërtimtarisë dhe nuk e kanë menduar se me kuadër tjetër (inxhinier) mundën me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në këto fakte ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet B58 - Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 08.05.2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit profesional. Si më poshtë :

Pershendetje te nderuar,

Konfirmojme pranimin e e-mailit dhe njeherit ju njoftojme se nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit dhe lusim panelin që të caktoj seancën për vendimin përfundimtar.

Gjithashtu gjeni të bashkangjitur edhe deshmi të marrura nga Dogana e Kosovës të cilat deshmojnë se paisja: Makine sperkatëse me emulsion është dërguar perkohesisht për punë jashtë shtetit me saktësi në Maqedoni dhe e njëjta është kthyer në gjendje të pandryshuar në Kosovë.

Ju lutem na e konfirmoni pranimin e e-mailit.

Me respekt,

Alfa.i shpk.

Administrata

alfa.i

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "ALFA I" SH.P.K - Lipjan sa i përket arsyes të eliminim nga ana e AK-së OE ankues shton se bërë marrëveshje për huazim të pajisjeve nga "Eskavatori SHPK", Kompani, kjo që ka dhe seli në Maqedoni (Bashkangjitur e keni marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve) DUD-in doganor që e kemi prezantuar është në pronësi e Eskavatorit MKD. Por ky mjet është dërguar në Maqedoni vetëm për realizimin e një projekti dhe është kthyer në Kosovë në të njëjtën gjendje (si dëshmi e kemi DUD-in që pajisja ka hyrë prapë në Kosovë por kjo dëshmi nuk ka qenë në dosjen e tenderit). Më tej, OE ankues shton se pronar i Eskavatorit MKD është Eskavatori SHPK (me atë që e kemi marrëveshje për qiramarrje të makinerisë. (si dëshmi shtesë keni të bashkangjitur dokumentacionin e biznesit të ESKAVATORI MKD ku shihet qartë që pronar është Eskavatori SHPK), e ku kuptohet qartë se kjo pajisje e kontestuar nga AK-ja është në pronësi të kompanisë me të cilën ne kemi bërë marrëveshje paraprake, prandaj me këto dëshmi ne e kemi përmbushur kërkesën e FTD-së, e të cilën autoriteti kontraktues e ka kontestuar. Paneli Shqyrtues konstaton se OE ankues përmes email të cilat ia ka dërguar edhe përfaqësuesve të AK-se, ka prezantuar dëshmi se kjo pajisje është dërguar në RMV dhe prapë është kthyer në R. Kosovës por AK nëse ka dyshime lidhur me këto dëshmi gjatë rivlerësimit mundet të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "ALFA I" SH.P.K - Lipjan se autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, ka bërë shkelje të LPP-së, duke e shpërblyer për kontratë OE "Rahovica Commerce" sh.p.k i cili është i pa përgjegjshëm për arsye se sa i përket udhëheqësit të punishtës të prezantuar nga OE të rekomanduar për kontratë, z. Shaban Krasniqi i cili edhe pse ka dy referenca të lëshuara nga Mirusha Company, më të cilën e plotëson kërkesën së ka kryer punë të ndërtimit të ultë dhe kërkesën për një projekt në vlerë prej 1.2 milion, në CV e z. Krasniqi nuk figuron askund se ka punuar në kompaninë Mirusha, por vetëm në kompanitë NNP "Liridoni" dhe NNSH "Top Projekt". Më tej, OE ankues shton i njëjti nuk ka të përmendur asnjë projekt të ndërtimit të ultë, por tek përshkrimi thuhet se ka bërë menaxhimin e punimeve ndërtimore në këto kompani por nuk dihet nëse punët e ndërtimit i përfshijnë edhe ato të ndërtimit të ulët apo vetëm të lartë. Këto dëshmi janë të dyshimta sepse po të kishte punuar inxhinieri në fjalë tek "Mirusha Company" atëherë do ta kishte shënuar edhe në CV-in e tij një gjë të tillë, prandaj është dashur të verifikohen këto dëshmi nga ana e AK-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se OE "Rahovica Commerce" sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë për udhëheqësin e projektit z. Shaban Krasniqi inxh. dipl. i ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv ka dorëzuar kontratën, referencat për punët e kryera si dhe CV-në siç janë kërkuar me FTD të dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirëpo OE ankues "ALFA. I" pretendon se udhëheqësi i projektit i caktuar në bazë të vendimit të OE

“Rahovica Commerce” sh.p.k në CV-in e tij nuk i ka të përshkruar eksperiencën profesionale në OE “Mirusha Company” e cila i ka lëshuar referencat për menaxhimin e projekteve në ndërtimin e ulëte për vitin 2016, 2017 dhe 2018. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se CV-ja -dokumenti i ofruar nga OE “Rahovica Commerce” sh.p.k për udhëheqësin e projektit z. Shaban Krasniqi inxh. dipl . i ndërtimtarisë- drejtimi konstruktiv paraqet devijim të vogël dhe në përgjithësi përmbushë kërkesën e kërkuar me FTD të dosjes së tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, kurse sa i përket kriterit që Udhëheqësi i punishtes duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë në vlerën e parashikuar të kontratës, në referencat e dorëzuar për udhëheqësin e projektit ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme. Andaj, pretendim i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “ALFA I” SH.P.K – Lipjan se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE “Rahovica Commerce” sh.p.k i rekomanduar me kontratë ka paraqitur dy inxhinier të ndërtimtarisë (z. Basret Selimi & z. Kadri Berisha), mirëpo nuk është përmbushur kërkesa e AK-së në këtë rast sepse punët e teknikeve të ndërtimtarisë duhet ti kryej tekniku e jo Inxhinieri, sepse kërkesë tjetër ka qen për inxhinier, pra janë kërkuar veçantë inxhinier e veçantë teknik të ndërtimtarisë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se OE “Rahovica Commerce” sh.p.k në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit te kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme: - 2 Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit vlerëson se kjo pike e ankese është e qëndrueshme sepse OE “Rahovica Commerce” sh.p.k në dokumentacioni e ofruar me ofertë për 2 teknik të ndërtimtaria ka ofruar dokumentacionin për -2 inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, andaj OE “Rahovica Commerce” sh.p.k me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë siç është kërkuar pasi qe ky kriter ka mundur qe të ndikoj qe shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse ne stafin e tyre nuk kanë pasur teknik të ndërtimtarisë dhe nuk e kane menduar se me kuadër tjetër (inxhinier) munden me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD ne dosjen e tenderit. Andaj, pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në bazë të sqarimeve të ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë vlerësimin, ekzaminimi dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që

konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shitesë nga OE i rekomanduar për kontratë se a i ka përmbush kërkesat dhe kriteret e kërkuara tek pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues, në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe pastaj të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktues duhet të kenë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në anën tjetër, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- "KK - Prishtinë",
- 1x1 OE- "ALFA I" SH.P.K - Lipjan,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.